Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/520
Datë: 21.08.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 12.08.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Akreditohet dhe Validohet "PROBIT ACADEMY" Sh.P.K me adresë: Lagjja Pejton, Rr. Pashko Vasa, Nr. 54 Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 12.08.2024 deri 11.08.2027, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1. **Zhvillues i Ueb Aplikacioneve, Niveli IV sipas KKK**, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 66 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin trajnues/mësimor me 12 (dymbëdhjetë) grupe brenda vitit. Numri i kandidatëve për një grup është 20, 18 dhe 15 kandidatë (*sipas kapaciteteve të sallave*), që në total i bie 636 kandidatë për vit kalendarik.

2. **Zhvillues Junior i Ueb Aplikacioneve**, Niveli III KKK, lloji: Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 50 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë trajnues/mësimor me 10 (dhjetë) grupe brenda vitit. Numri i kandidatëve për një grup mund të jetë maksimalisht 18 (tetëmbëdhjetë) kandidatë, që në total i bie 180 kandidatë për një vit kalendarik.

3. **Zhvillues Junior i Aplikacioneve** , Niveli I KKK, lloji Kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare (E) me 30 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë trajnues/mësimor me 17 (shtatëmbëdhjetë) grupe brenda vitit kalendarik Numri i kandidatëve për një grup është 21, 18 dhe 15 kandidatë (*sipas kapaciteteve të sallave*), që në total i bie 918 kandidatë për vit kalendarik.

II. Obligohet Institucioni të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues Nr.01/402 të datës 13.06.2024.